## MATERIALE SHKENCORE E KUMTESA

# KRONIKA E SHKODRËS 1831-1839
# NGA DOM ZEF BUBÇI, FAMULLITAR I SHKODRËS[1]

**Transkriptimi, përkthimi dhe shënimet punuar nga Injac Zamputi, Tiranë 1977**

**Përgatitja për botim e teksteve në të dyja gjuhët nga Edmond Malaj**

### Parathënie

Kronika e Shkodrës e viteve ’30 të shek. XIX, është shkruar nga dom Zef Bubçi, famullitar i Shkodrës. Kjo kronikë ka në qendër të vëmendjes sidomos dy ngjarjet më kryesore: fundin e sundimit të Bushatllinjve, me dorëzimin e Mustafë Pashës, dhe kryengritjen e Shkodrës të kryesuar nga Hamz Kazazi. Preket pastaj me ndonjë shënim edhe lufta me malazezët për Zhabjakun etj.

Autori ka pasur në dorë një fletore të formatit të vogël, siç mund të vërehet edhe nga sasia e tekstit që përfshihet në secilën faqe të saj. Ai, siç duket, i kishte vënë vetes për detyrë të shënonte vetëm ngjarjet e rëndësishme. Për një plan të tillë, nuk duhet të ketë qenë pa rëndësi edhe vetë masa dhe numri i faqeve të fletores. Nuk është pra një ditar personal që të regjistrojë dita-ditës punët ose ngjarjet, me ose pa rëndësi, që ndodhnin në jetën e autorit.

Vetë ligjet e kronikës pësojnë këtu ndonjë çrregullim. Ngjet që para syve të autorit kalon pa u shënuar ndonjë ngjarje e cila, në fillim, nuk duket me rëndësi, por pastaj, nga rrjedhimet e saja, del se duhej shënuar; atëherë autori e rikap ngjarjen duke bërë një kthesë në kohë.

Kur ngjarjet politike të Shkodrës, në gjykimin e autorit, nuk kanë atë peshë që të meritojnë shënime në kronikë, ndodhin kapërcime kohore edhe të gjata. Kështu shpjegohet se si, në 33 faqet e vogla të fletores, të përfshihet një periudhë e gjatë 9-vjeçare (1831-1839).

[1] Materiali që po botohet ndodhet në Arkivin e Institutit të Historisë, me shifër A-III-79.

Autori e nis kronikën më 10 korrik 1831, kur Mustafa Pasha po rrethohej nga të katër anët prej ushtrive të sulltanit. Jemi pra në aktin e fundit.

Ndoshta, duke shtruar në plan të punës së vet, nevojën që të bëhej një parahistori e ngjarjeve të mëdha që po ndodhnin, autori i lë të pashkruara shtatë faqet e para të fletores, duke e nisur kronikën te fq. 8. Por pastaj, koha dhe ngjarjet ecnin dhe ato shtatë faqet e para nuk u mbushën deri në vitin 1839. Me shënimin e 4 tetorit 1837, autori mbush faqen e parafundit të fletores. Ndërkaq, në faqen e fundit të saj kishte bërë disa shënime llogarish personale, dhe gjendet ngushtë për vendin ku do ta vazhdonte kronikën. Atëherë i kujtohet se ka shtatë faqet e para të pashkruara dhe tashmë parahistoria e ngjarjeve të Mustafa Pashës s'kishte kuptim. Në këtë mënyrë kthehet dhe e vazhdon kronikën te faqja 2 deri te faqja 5.

Kështu që fletores i mbeten të pashkruara fq. 1 dhe fq. 6-7. Duke e ndërprerë kronikën e vet te fq. 5, nuk është se autorit i ka munguar vendi në fletore, që të mendohet se mos ka ndonjë fletore tjetër që nuk dihet. Për ndërprerjen e kronikës pra duhen kërkuar arsye të tjera që ne na ikin ose autorit i kanë munguar ngjarjet e mëdha, ose ai vetë është sëmurë ose larguar nga Shkodra. Në transkriptimin që i kam bërë origjinalit unë kam ndjekur dhe riprodhuar *vetë fletoren* ashtu siç paraqitet, pa analizën që i bëra brendisë së saj. Kështu nis te fq. 2 me shënimin e datës 4 tetor 1837 dhe e vazhdoj siç është deri në fund.

Por, duke e dhënë përkthimin e saj, kam menduar të bëj rindërtimin e lëndës sipas analizës që i kam bërë. Për këtë arsye, përkthimi ndjek rendin kronologjik të shënimeve, duke filluar nga fq. 9 dhe duke kthyer pastaj, pas fq. 33, te fq. 2-5.

Përkthimin e kam pajisur me disa shënime përshtatur për një kuptim të drejtë të tekstit, duke bërë sqarime për situatat, për vendet, për kohën etj., por pa hyrë në komentimin e ngjarjeve historike, gjë që është për studiuesit e kësaj periudhe dhe të kësaj kronike.

Kjo kronikë ka qenë botuar, por vetëm në tekstin origjinal, në revistën *ALBANIA* (1906, v. X, nr. 5). Aty ka disa ometime të pakta siç janë shënimi i 14 tetorit 1837 dhe i 24 gushtit 1838 te fq. 2; shënimi i 19 shtatorit 1839 te fq. 5; shënimi i 1 prillit 1855 te fq. 12; shënimi i 20 shtatorit 1835 te fq. 30; një copëz te shënimi i 12 korrikut 1836 dhe ndonjë fjalë tjetër që studiuesi do të ketë mundësi të hetojë duke krahasuar dy transkriptimet.

Tiranë, korrik 1977 **Injac Zamputi**

# KRONIKA E SHKODRES 1831-1839
# NGA DOM ZEF BUBÇI, FAMULLITAR I SHKODRËS

## Përkthimi

*Më 10 korrik 1831:* Mustafa Pasha, pasi ulqinakët ngritën krye, dërgoi Hysen Shllakun me katër mijë veta shkodranë, nergut që të plaçkitnin dhe të pushtonin të thënin qytet të Ulqinit. Arritën, pas një udhëtimi të mbarë, te një fshat i quajtur Zogaj.[2] Këtu, një i quajtur Suli u grind me Halil Gilanin dhe menjëherë, ai trimi Suli shtini në pushkë të madhe[3], dhe e plagosi keqas Shllakun[4], dhe gjithashtu, me pistolë[5], plagosi vetë Gilanin. Pastaj trimat e Hysen Agës e vranë të sipërthënin Suli. Në atë çast ushtria iku për Shkodër, me turp e çnderim. Si arriti Shllaku në shtëpi të vet ashtu i plagosur, në krye të tri ditëve dha shpirt.[6]

*1831. Shënime.*
*Më 5 korrik:* Ulqini u ngrit kundër vezirit të Shkodrës dhe, në krye të dy ditëve, me gëzim të madh dhe me të shtëna topash, hyri ushtria e sulltanit. Oh, ç'qetësi për vetë qytetarët ulqinakë![7]

*Më 13 korrik 1831:* Është vënë në të ikur ushtria e vezirit nga Lezha të cilën menjëherë e shtini në dorë Veziri i Madh Sadriazemi, dhe hyri brenda me ushtri të shumta.

---

[2] Edhe sot ky vend është në lindje të Ulqinit, pikërisht në rrugën e Shkodrës.

[3] Kuptohet: pushkë e gjatë, pushkë e krahut dhe jo e brezit.

[4] Kuptohet se ka plagosur Hysen Agë Shllakun, komandantin e ekspeditës i cili, me sa duket, kishte hyrë në mes për të shuar grindjen.

[5] Pistola ishte armë brezi.

[6] Origjinali thotë fjalë për fjalë ia ktheu shpirtin Muhametit. Po shënoj se, edhe te botimi i bërë në "Albania", nuk figuron fjala *Maometo,* e cila është zëvendësuar me tri pika.

[7] Ky shënim sqaron çdo gjë: më 5 korrik, Ulqini, duke parë se ushtria e sulltanit i ishte afruar qytetit (ashtu edhe Tivarit e Lezhës, sikundër del më poshtë) çon krye kundër Mustafa Pashës. Më 7 korrik hyri aty ushtria e ekspeditës kundër Mustafa Pashës. Ky, më 10 korrik, nisi ekspeditën e vet që siç u tha më lart, nuk arriti veçse deri në Zogaj dhe u kthye me turp.

*Më 14 korrik 1831:* Pa ndonjë pengesë ra Tivari, prej nga menjëherë iku ushtria shkodrane pa asnjë trimëri. Oh, ç'gëzim patën ushtarët e sulltanit!

*Më 2 gusht 1831:* Sot, me fat të mbarë, hynë në grykën e Bunës dy anije të vogla me dy copë topa të sulltanit me të vërtetë të mëdhenj, nergut për të rrahur të shkretin qytet apo kalá të Shkodrës. Oh, ç'mjerim për të sipërthënën krahinën tonë[8]!

*Më 8 të gushtit 1831:* Ngjau një betejë e vogël me malësorët në vendin që quhet Buzë Bok.[9] Ushtria e sulltanit doli dhe e mundi atë ushtri [të malësorëve] dhe i shkaktoi një thyerje të tmerrshme, aq sa mbetën të vdekur rreth tridhjetë veta nga malësorët, për më tepër katër i kapën të gjallë dhe menjëherë i nisën në mërgim me flluga[10], por nuk dihet se ku etj.

*Më 11 gusht 1831:* Qe bllokuar[11] qyteti i Shkodrës nga ushtria e sulltan Mahmudit etj. Të shohim si do t'i dalë fundi.[12]

---

[8] Mund të lihej edhe termi provincë siç e ka origjinali: ashtu edhe te shën. Nr. 27.

[9] Siç shihet, malësorët besnikë tentuan t'i vinin në ndihmë Mustafa Pashës që tashmë mbahej i ngujuar në fortesën e Rozafatit. Në lidhje me vendin se ku u zhvillua kjo betejë, nuk di të them diçka të sigurt. Po shënoj veçse, në lindje të Shkodrës, janë "Bokat e Kirit". Nuk është këtu vendi të tentoj shpjegimin se si ka zënë fill ky toponim, por po shënoj se, ne shkodranët, pavarësisht nga origjina e fjalës, për "Bokat e Kirit" kuptojmë kodrinat e vogla që vijnë fill përtej rrjedhës së Kirit, kur kjo rrjedhë shkon për t'u derdhur në Drinasë. Ka shumë mundësi që kjo betejë të jetë zhvilluar aty ku, veç të tjerash, më 1912-1913, në kohën e rrethimit të Shkodrës nga Mali i Zi, ishte krijuar një nga frontet e rezistencës.

[10] Lloj anijesh. Dihet se lumi i Bunës është i lundrueshëm dhe, nëpër të, anijet hyjnë edhe në Liqen. Kurdoherë Buna dhe Liqeni kanë qenë përdorur nga ata që kishin sundimin e Shkodrës për të ushtruar rojën dhe për të mbajtur nën bindje popullsitë e rrethit. Por lundrimi nëpër Bunë ka qenë shtënë në punë edhe kur qe fjala për të sulmuar Shkodrën, siç është pikërisht ky rasti i fundit. Në lidhje me këtë, vetë fortesa e Rozafatit është ndërtuar në mënyrë të tillë që vendi i vrojtimit kryesor *(belvedere)* shikon pikërisht në anë të Bunës. Të rrethuarit në fortesën e Rozafatit shikonin nga Buna, jo vetëm për të qenë në korrent të forcave që vinin nga deti kundër tyre, por ndonjëherë edhe sepse pikërisht nga deti prisnin t'u vinin ndihmat. Një rast i tillë qe për shembull ai i rrethimit më 1474 kur të rrethuarit shkodranë me Anton Loredanin në krye, morën guximin të vazhdonin qëndresën e s'u dorëzuan, kur panë se anijet po lundronin nëpër Bunë drejt Shkodrës.

[11] Folja *abblocare* që përdor këtu shkruesi duhet të jetë në vend të foljes *bloccare* = *bllokoj*. E vërteta duket se është tamam një bllokim sepse puna nuk arriti te një rrethim i mirëfilltë sipas ligjeve të luftës.

*Më 5 të nëntorit 1831:* Arriti në Shkodër Sadriazemi dhe, të nesërmen, Mustafa Pasha vetë i katërti[13] shkoi tek ai Sadriazem dhe e dorëzoi fortesën me turp e çnderim shumë të madh. Dhe në krye të dy ditëve doli ushtria që ishte në kështjellë. Pastaj, të katërtën ditë [doli] edhe veziri, me të gjithë familjen[14] dhe menjëherë qenë futur në anije në Shëngjin [drejtuar] për Kostantinopol.

*Më 12 janar 1832:* Sadriazemi u nis në Manastir me shumë zotërij shkodranë muhamedanë.[15]

*Më 1 prill 1833:* Një gjakua[16] i quajtur Gjon vrau me vërcak Pjetër Gjinajn, ish peshkop i Pultit. Oh, ç'mizori e prapë![17]

*Më 7 gusht 1833:* Ali Pasha, me vullnetin e vet, dërgoi në krye të Pazarit, përmbi Tabakët, një Ysbash me njëqind veta nergut për të vrarë Isuf Beun. U kacafytën të dy palët me disa të shtëna pushkësh, dhe mbeti i vdekur Ysbashi me disa nizamë të vet. Gjithashtu të sipërthënit Isuf Beut i mbetën të vdekur tre veta nga trimat e tij. Menjëherë nizamët, si bisha të egra hynë në Pazar dhe plagosën nëntë katolikë[18], dhe bile, njërit që quhej

[12] Shprehja latine, të cilën autori i kësaj kronike e bie [sjell] disa herë *respice finem*, d.m.th.: *Rri e shikoj si do t'i dalë fundi*. Ne e kemi një shprehje popullore: *"Fundi daltë hair"*, por nuk m'u duk me vend ta përdor këtu sepse ky lloj urimi do t'i jepte një nuancë që nuk më duket se ishte e përshtatshme për rastin tonë.

[13] Fjalë për fjalë: *në katër veta* (jo me katër veta). Kam përshtypjen se, disa herë, autori i kësaj kronike përkthen shprehjen shqipe me një frazë të pazakontë për italishten. Do të takojmë diçka më të dukshme më tutje.

[14] Fjala *familja*, në raste të tilla, ka pasur një kuptim të ndryshëm nga si e ka sot: kuptohej i gjithë rrethi shërbyes që shkonte pas feudalit dhe ndiqte fatin e tij si në ditë të mirë, ashtu edhe në ditë të keqe. Megjithatë, mendoj se, në rastin konkret flitet edhe për familjen me vështrim të ngushtë.

[15] Fjala *ottomano* ashtu sikundër tjetra *turco*, në këto raste nuk ka vështrim kombësie.

[16] Kandidat për t'u bërë prift; nxënës për çështjet fetare.

[17] Këtë shënim, botuesi te *Albania* e ka parë të udhës, për arsyet e veta, ta heqë. Autori i kronikës e regjistron si fakt, por nuk na jep shkakun e kësaj vrasjeje. Sidoqoftë, është një episod më vete që nuk ka lidhje me ngjarjet e mëdha.

[18] Siç dihet, pazari i Shkodrës ka qenë te rrëzat e kodrës së Rozafatit, në anën veriore buzë Bunës. Në këtë pazar ishin dyqanet e tregtarëve dhe të zejtarëve, të ndara në sokakë dhe dyqanet ishin së bashku, pavarësisht nga besimi i tregtarit ose i zejtarit. Kjo gjë nuk ndodhte në qytetin e banuar të Shkodrës. Pazari i Shkodrës ka qenë vetëm si një qendër pune ku takoheshin interesat ekonomikë të të gjithëve, ishte i pabanuar

Anton, ia prenë kokën. Dhe menjëherë i gjithë qyteti[19] iku ndër shtëpitë e veta me shpejtësi shumë të madhe. Oh, ç'ngjarje tjetër e kobshme qe kjo për të shkretin krishterim[20] dhe Zoti e di se si do të përfundojë!

*Më 10 gusht 1833:* Myslimanët[21] e katolikët janë mbledhur së bashku dhe menjëherë kanë dërguar katër veta te sulltani me arzuhalle (lutje) kundër këtij sundimtari mizor. E bëftë Zoti mirë[22]. Të shohim si do të dalë fundi.[23]

*29 shtator 1833:* Ka arritur një admiral nergut për të vizituar (hetuar) punët e Shkodrës, se si kanë rrjedhur fatkeqësitë e qytetit të Shkodrës më 17 gusht[24] 1833, dhe nuk dihet asgjë me siguri se si do t'përfundojnë fatkeqësitë e sipërthëna.

*6 tetor 1833:* Arritën nga Kostantinopoli ata veta që qenë dërguar me arzuhalle (lutje) nga populli i bashkuar i Shkodrës, por pa asgjë të caktuar prej sulltanit. Dhe nuk dihet se si do të marrë fund çështja e Shkodrës me këtë komandant (sundimtar) shumë mizor që quhet Ali Pasha nga Moreja.[25]

---

nga familjet dhe natën mbyllej duke u lënë në rojën e pazvanëve. Qyteti si vend banimi, kishte lagjet e ndara sipas besimit: në anën lindore dhe juglindore ishin lagjet katolike, në anën veriore, veriperëndimore, perëndimore e jugore, ishin lagjet myslimane. Ajazma e Tabakët ishin lagjet e vjetra në Lindje të Rozafatit, të banuara ekskluzivisht nga familje myslimane, por tashmë, në fillim të shek. XIX, këto dy lagje kishin mbetur në periferi të qytetit që ishte shtrirë në fushë.

[19] Kuptohet banorët e qytetit.

[20] Nuk duhet harruar se autori i kronikës është një prift dhe i vjen keq për besimtarët e vet, dhe harron se më parë na ka folur për vrasjet që janë bërë në ambientin mysliman, por për ata të vrarë nuk ndien as dhimbje ashtu sikundër nuk ndien as përgjegjësi morale.

[21] Shih shën. Nr. 14.

[22] Ja një urim i krijuar në italisht sipas rregullës së gjuhës shqipe, pa marrë parasysh rregullat e vetë italishtes.

[23] Shih shën. Nr. 11.

[24] Fatkeqësitë, apo përleshja në pazarin e Shkodrës, janë shënuar në kronikë më 7 gusht dhe aty nuk ka dyshim as mundësi gabimi, sepse numri është shkruar me fjalë: *sette* = *shtatë*.

[25] Është Moralli Ali Pasha.

*2 nëntor 1833:* Arriti tatari[26] nga Kostantinopoli me fermanin e sulltanit në favor (përkrahje) të popullit. Prandaj qyteti bëri hare me shumë të shtëna pushke. Dhe Ali Pasha duhet të largohet me turp nga Shkodra.

*4 nëntor 1833:* Sot u hap pazari i Shkodrës nga i shkëlqyeri mirallaj. U gjetën gjithsej 200 dyqane të plaçkitura në pazarin e Shkodrës. I sipërthëni mirallaj u zotua ta shpërblejë në çdo gjë grabitjen e dyqaneve, dhe u ujdis për tri afate. Prandaj ditën e Shën Antreut[27] pagoi pjesën e tretë dhe ato që mbeten do t'i paguajë në të ardhmen.

*2 dhjetor 1833:* I prapti Ali Dacha sot, dy dhjetor 1833, me çnderim e turp, u nis nga saraji (keshtjella) i krahinës sonë[28] të Shkodrës së Shqipërisë[29], dhe nuk dihet se ku po shkon dritëshkurtri.

*6 janar 1834:* Arriti Pasha i ri që quhet Hafiz Pasha, i cili thuhet se nuk është mizor.

*25 janar 1834:* I shkëlqyeri mirallaj u nis nga Shkodra me çmim shumë të madh[30] për në Kostantinopol. Ai ka qenë një njeri me gjykim shumë të madh dhe i mençur. Zoti e shpëntë shëndoshë në cakun e tij.[31]

*20 mars 1834:* I erdhi diploma (dekreti) nga sulltani sundimtarit të ri të quajtur Hafiz Pasha që, siç thuhet, është i drejtë. Të shohim si do t'i dalë fundi.[32]

---

[26] Tatarët - origjinali shkruan *tartarët*, siç ishte krijuar gabimisht zakoni në historiografinë europiane - ishin korrierët zyrtarë.

[27] D.m.th. më 30 nëntor. Siç shihet këtu, autori i kësaj kronike vazhdon të japë shënime për ngjarje që nuk i përkasin datës që vë në krye, por ngjarje që vijnë më vonë.

[28] Shih shën. Nr. 7.

[29] Shënoj se, mbase gabimisht, në gjuhët europiane, në vend të trajtës *Shkodra* (ose *Scodra* siç është që në kohën ilire) u tha *Scutari*, u pa më pas nevoja të përcaktohej *Scutari d'Albania* për ta dalluar nga omonimi *Scutari-Skutari* pranë Kostantinopolit.

[30] E përktheva fjalë për fjalë shprehjen pa e ditur mirë se çfarë ka dashur të thotë me të autori i kronikës. Mos ka dashur t'i japë fjalës *prezzo* vështrimin e përfitimit, të fitimit (*lucro*)? apo vështrimin e rëndësisë, vlerës, stinës (*apprezzamento*)? Siç shihet, ka mundësi për kuptim të ndryshëm. Por, meqenëse flitet mirë për të, mendoj se i duhet dhënë shprehjes kuptimi i dytë: *shumë i çmuar, shumë i stimuar* etj.

[31] Fjala *destino* d.m.th. *fat*, por këtu më duket se ka vështrim konkret: caku ku do të arrijë (*destinazione*).

[32] Shih shën. Nr. 11.

*19 mars 1834:* Pas një udhëtimi të mbarë, arriti këtu në Shkodër imzot Gabriel Barisiqi, ipeshkëv i Lezhës dhe vizitator[33] i të gjithë Shqipërisë dhe nuk dihet [kur do të ngjasë] nisja e tij për n'dioqezin e sipërthënë të vet.

*7 gusht 1834:* Arriti në Shkodër Daut Pasha me gjashtë regjimente, nergut për të bërë trupa (ushtarë) me këta shkodranët krenarë.

*12 gusht 1834:* Të parët e Shkodrës, d.m.th. Halil Beu, Sulem Beu, Molla Beu, Isuf Beu dhe Cano Beu, ikën natën nga Shkodra me turp e çnderim, dhe nuk dihet se për ku; dhe gratë e të sipërthënëve bejlerë qenë marrë përdhuni dhe qenë mbajtur peng, po ashtu edhe plaçkat e shtëpisë.

*17 gusht 1834:* Ushtria e Daut Pashës sot bëri stërvitje me zjarre në fushën e Tabakëve te vendi i quajtur Fusha e Spahive.

*Më 16 shtator 1834:* Ushtria e Daut Pashës bëri stërvitje me zjarr në fushën e Manit të Met Asllanit[34], një bukuri për t'u parë!

*30 dhjetor 1834:* Arritën nga Selaniku zotrijtë shkodranë që qenë dërguar në mërgim nga veziri Sadriazem; u kthyen ata që kishin mbetur gjallë.

*11 shkurt 1835:* Shumë herët, në fortesë u bënë shumë të shtëna artilerie sepse ky i tanishmi Hafiz Pasha ka nxjerrë nga sulltani fermanin se është sundimtar i denjë i Epirit.

*15 mars 1835:* Podgoriçajt kanë sjellë 17 koka malazezësh dhe, për më tepër, kanë kapur kafshë, rreth një mijë dele.

*20 mars 1835:* Nga malazezët u mor fortesa e Zhabjakut, ku ata plaçkitën çdo gjë që gjetën brenda. Sapo dëgjoi ngjarjen Hafiz Pasha, dërgoi të gjithë myslimanët e Shkodrës, ashtu edhe Malësinë e Mbishkodrës. Për

---

[33] E kam lënë fjalën *vizitator* si term: ishte një detyrë periodike që Vatikani u caktonte klerikëve të ndryshëm për të kontrolluar si ecnin punët e dioqezave kishtare në vende të ndryshme.

[34] Fjala e parë *Mani* mund të jetë edhe emër njeriu, por ka të ngjarë se bëhet fjalë për një vend ku ishte një *man*, pronë e Met Asllanit, si p.sh. Çinari i Zorbës, Arra e Madhe etj.

më tepër ai vetë, i sipërthëni pashë, shkoi me anije nëpër Liqen, ashtu edhe, nëpër tokë [shkuan] dy regjimente të sulltanit. Kështu që malazezët ikën me turp nga fortesa e sipërthënë.

*19 maj 1835:* Më tri orë natë[35] filloi beteja kundër të tanishmit Hafiz Pashës dhe Daut Pashës. Kreu i kësaj beteje të sipërthënë është Hamz Kazazi me Hysen Beun dhe me myslimanë [të tjerë] shkodranë. Dhe beteja e vazhdueshme zgjati me siguri 60 orë. Beteja e dytë filloi më 24 të vazhduesit, në ora 9 të mëngjesit, dhe nuk dihet mbarimi.[36] Por duhet shënuar se *më 9 të qershorit 1835,* në ora tetë e gjysëm të ditës, nizamët bënë luftë kundër popullit të Shkodrës në vendin e quajtur Kir[37] dhe për tri orë zgjati beteja ku, nga qyteti, mbetën të vdekur dhe të plagosur rreth tridhjetë veta, kurse për nizamët nuk dihet numri i të rënëve. Për më tepër, po shënohet se *më 14 qershor 1835,* u bë prej nizamëve një betejë në vendin e quajtur Grenasi[38], dhe zgjati 6 orë[39], kundër popullit mysliman të Shkodrës, ku mbetën të vdekur e të plagosur, si nga qyteti ashtu edhe nga morlakët, rreth njëqind veta, kurse nga ushtria e sulltanit nuk dihet numri i të rënëve. Kështu, në atë egërsi, Hamz Kazazi me një mijë veta pushtoi shtëpitë e Tabakëve, deri te vendi i quajtur Uslup (Çezëm?), dhe menjëherë dogjën shtëpinë e Selim Reçit, dhe kështu pra lufta është e vazhdueshme, është në këmbë.

*Më 18 qershor 1835:* Gjatë natës, dolën nga saraji[40] gjashtëmbëdhjetë veta të baroshit[41] dhe treguan se ushtria po heq keq për ushqime.[42] Për më

[35] Meqenëse më poshtë thotë, për betejën e dytë, se filloi në ora 9 të mëngjesit, duhet menduar se shkruesi i numëron orët sipas mënyrës së sotme, prandaj edhe këtu kuptohet në ora 3 pas mesnate. Por mund të jetë edhe ndryshe.

[36] Duket se autori e shkruan këtë shënim sa është në këmbë ajo betejë: kjo nxirret edhe nga shprehja: më 24 të vazhduesit, pra në maj. Shënimet që ndjekin kalojnë në qershor.

[37] Në Shkodër, nuk më kujtohet të ketë një vend të quajtur Kir, por është lagjja *Kiras*, është edhe *Zalli i Kirit*. Meqenëse betejat e kësaj kohe u zhvilluan rreth lagjes së Tabakëve, mundet që këtu duhet lokalizuar pikërisht te *Zalli i Kirit*.

[38] Nuk më kujtohet një toponim i tillë. Duke e lidhur me shënimin e mëparshëm, ndoshta këtu bëhet fjalë për *Drinasën*. Kjo ka mundësi sepse, pas betejës, siç thuhet më poshtë, Hamz Kazazi pushtoi shtëpitë e Tabakëve.

[39] Ky shënim është shkruar sipri radhës dhe shkruesi nuk e ka caktuar se ku duhet futur.

[40] Mendoj se është kështjella, pra: fortesa e Rozafatit.

[41] Mendoj se duhet kuptuar: banorë të lagjeve të reja të qytetit të Shkodrës.

[42] Origjinali thotë: është në mjerim për ushqime.

tepër, thanë se Hafiz Pasha ka vënë ndër pranga të gjithë shkodranët që e kanë këshilluar të veprojë dhe të luftojë kundër popullit të Shkodrës. Gjithashtu, deklaruan se Daut Pasha është plagosur po atë ditë kur u bë beteja e tmerrshme në vendin e thënë më lart, më 24 të këtij muaji.[43] Dhe tani fortesa është bllokuar[44] nga këmbëngulësi populli i Epirit. Dhe Zoti e di si do t'i dalë fundi.

*Më 27 të qershorit 1855:* Në ora nëntë të mëngjesit[45], ndër Tabakët, ushtria e sulltanit u sul kundër kryengritësit mysliman të Shkodrës[46], dhe beteja zgjati për një kohë prej 13 orësh. Mbetën të vrarë e të plagosur, siç më kanë thânë, rreth gjashtëdhjetë veta, kurse për nizamët nuk dihet numri. Për më tepër, qytetarët sollën dy koka dhe një të plagosur nga të nizamëve, si edhe shumë shpata e pushkë, siç kanë deklaruar. Në vazhdim do të shënohet me përpikmëri.

*Më 6 korrik 1835:* Cano Beu shkoi për Lezhë me 500 veta kundër pashës së Krujës, dhe do të shënohet fundi.

*Më 7 korrik 1835:* Erdhën me flamur podgoriçajt, rreth njëqind veta, siç thonë, për të luftuar kundër sundimtarit të tanishëm.

*Më 13 korrik 1835:* U nisën nga Shkodra për Lezhë gjashtëmbëdhjetë flamuj kundër pashës së Krujës dhe Ashik Pashës së Dibrës dhe pashës së Peqinit dhe pashës së Tetovës. Të nesërmen[47], shumë herët bënë luftë në pazarin e Lezhës ku, nga tanët, siç thonë, kanë mbetur rreth 150 veta të vdekur e të plagosur, dhe pashallarët e sipërthënë qenë thyer prej morlakëve dhe ikën me çnderim e turp shumë të madh për në vendet e veta.

---

[43] Unë mendoj se bëhet fjalë për betejën e 24 majit (shih shën. Nr. 35). Me të vërtetë, ata që kanë dalë nga kështjella më 18 qershor nuk kanë si të flasin për një betejë të 24 qershorit, por të majit.

[44] Shih shën. Nr. 10, por këtu fjala *bloccare* mund të ketë një vështrim më të ngushtë, pra: *rrethuar*.

[45] Shih shën. Nr. 54.

[46] Është në numrin njëjës: i referohet, siç është e qartë, kreut të kryengritjes, Hamz Kazazit.

[47] Të nesërmen e cilës ditë? Unë mendoj se nisja nga Shkodra ka ndodhur, ta zëmë më 13 korrik, dhe lufta është zhvilluar një ditë pasi flamujt e Shkodrës kishin arritur në Lezhë, para 24 korrikut.

*Më 24 korrik 1835:* Arriti nga veziri i Rumelisë (Rumelivari) një nëpunës i Portës së Lartë[48] për të bërë hetime se si janë zhvilluar ngjarjet e Shkodrës. Dhe menjëherë mblodhi myslimanët, konsullin e Austrisë, imzot Albertinin dhe katolikët[49]. Aty u bë pyetja e përshtatshme si ka rrjedhur lufta kundër Hafiz Pashës dhe Daut Pashës. Bënë këshillë të bëheshin arzuhalle (lutje) si nga myslimanët ashtu edhe nga katolikët, dhe menjëherë i shkruan. Dhe më *26 të vazhduesit* dërguan dy myslimanë e një katolik, të quajtur Gjon Rakacolli, te Rumelivari në Manastir; ashtu edhe i sipërthëni [i dërguari i Portës] u nis me të siperthënët shkodranë.

*Më 29 korrik 1835:* Në ora shtatë të ditës ia nisi beteja në vendin e quajtur Kazene.[50] Beteja zgjati për një kohë prej katër orësh dhe mbeti i plagosur rëndë kreu i betejës Hamz Kazazi, dhe mbetën të tjerë të vdekur e të plagosur, por numri nuk dihet. Për më tepër, siç thuhet, nga nizamët kanë mbetur të plagosur e të vdekur me shumicë. Shkaku i kësaj beteje qe se kryengritësit e kanë mbyllur me hekura (zinxhirë) Liqenin në vendin e quajtur *Guri i shën Gjonit*[51] që të mos hyjë barka me ushqime. Beteja është e papushim në vendin e sipërshënuar, por, në atë ashpërsi i këputën zinxhirët dhe barka hyri në Bunë.

*30 korrik 1835:* Shala e Shoshi, me tre flamuj (bajrakë) zbritën këtu në Shkodër kundër Hafiz Pashës dhe Daut Pashës. Në ora gjashtë.[52]

---

[48] Kështu e kam lexuar: *Umilissimo di Sublimita* = shumë i përvuajturi i së Lartës, dhe e kam kuptuar: një nëpunës i (ose skllav, siç quheshin të dërguarit e sulltanit) Portës së Lartë (që ishte qeveria e sulltanit).

[49] Kuptohet të parët ose krerët e qytetarëve myslimanë e katolikë. Konsulli i Austrisë, në regjimin e kapitulacioneve dhe në veprën ekspansioniste të Perandorisë Austro-Hungareze, ashtu edhe ipeshkvi katolik që gëzonte mbrojtjen e kësaj perandorie, përgjigjeshin për katolikët.

[50] Në këtë kohë, *Kazenet* gjendeshin në bregun e djathtë të Bunës, ku ky lum del nga Liqeni. Kështu shpjegohet edhe mundësia e mbylljes së kalimit me zinxhirë.

[51] Nuk e njoh këtë toponim. Duhet të jetë aty pranë Kazaneve në krahun e Shirokës, sepse mbyllja e kalimit ishte bërë që barka të mos hynte nga Liqeni në Bunë, siç hyri pastaj kur u këputën zinxhirët. Po shënoj se shkruesi, nga fundi i faqes 26, me një vizë horizontale sa merr e gjithë faqja, të thyer me viza të vogla vertikale, ka dashur, siç duket, të japë idenë e mbylljes që i është bërë me zinxhirë atij vendi pranë *Gurit të Shën Gjonit*.

[52] Ky shënim i dhënë kështu për kohën, duket sikur nuk ka kuptim. Nuk më duket se duhet lidhur me atë që thuhet më parë, d.m.th. se Shala e Shoshi zbritën *në orën*

*Më 3 gusht 1835:* Në ora gjashtë të ditës, në Kazene, u përleshën nizamët me shkodranët dhe bënë luftë të përgjakshme. Aty kryengritësit korrën fitore dhe thonë se sollën 150 nizamë të gjallë. Të vdekur e të plagosur[53] nga të dy palët, por nuk dihet numri. Beteja zgjati për tetë orë. Beteja është në këmbë.[54]

*Më 10 gusht 1835:* Në ora 12, nga të gjitha vendet u hoqën shatorret apo çadrat dhe u bë paqja me të dy pashallarët, dhe në pazarin e Shkodrës gjetën, siç thonë, 490 dyqane të hapura.

*Më 22 tetor 1835:* Veziri i Madh, Mahmut Pashë Terhalla, dërgoi në mërgim tre pashallarë dhe kadiun e Shkodrës, Topaliun, dhe myftiun Molla Brahim Baçellekun. Dhe qenë futur ndër anije në Shëngjin të Medes.[55]

*Më 12 gusht 1835:* Erdhën nga valiu i Rumelisë Gjon Rakacolli dhe ata dy myslimanët, por nuk doli asnjë fjalë. Sërish, më 18 gusht 1835, Gjon Rakacolli me dy myslimanë u nisën te valiu i Rumelisë në Manastir. Më 23 kthyen si shkuan[56], për faktin se Rumelivari, me shumë ushtarë po vjen për Shkodër që të ujdisë gjërat. Kryengritësit, të egërsuar, nuk duan t'i hapin shteg. Prandaj duhet shënuar se *më 1 shtator* u nisën nga

---

*gjashtë*. Unë mendoj se autori i kronikës ka dashur të vazhdojë shënimet, por pastaj është kujtuar se duhej ndryshuar data. Kështu që, *në orën gjashtë* është lënë pa u shlyer për harresë, dhe përsëritet fill pastaj pas datës.

53 Fjala *periti* e origjinalit në këtë vend duhet marrë si një gabim shkrimi në vend të fjalës *feriti*, sepse nuk ka kuptim të rreshtohen dy sinonime: *të vdekur* e *të rënë*.

54 Edhe pse në italisht ekziston shprehja *essere in piede* (me qenë i gatshëm etj.), do të vërej se nuk merr kuptimin "*vazhdoj*" etj. siç e ka në gjuhën shqipe shprehja *"është në këmbë"*. Sikundër e them te shën. Nr.12, më duket se edhe ky është një nga rastet e përkthimit fjalë për fjalë që i bën autori shprehjes shqipe. Shih po këtë shprehje edhe te fq. 22 e origjinalit.

